

M. ÇELIKU, *ÇËSHËTJE TË SHQIPES STANDARDE*, TIRANË, 2006, 450 fq.

Kohët e fundit doli në qarkullim vëllimi me studime “Çështje të shqipes standarde” (me afër 450 faqe), hartuar nga prof. Mehmet Çeliku, pedagog në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” të Elbasanit dhe njëri ndër gjuhëtarët specialistë, më në zë, për probleme të standardizimit të shqipes. Në të vërtetë ky vëllim është një ribotim i plotësuar dhe i përmirësuar i përmbledhjes me të njëjtin titull të botuar disa vjet më parë nga Shtëpia Botuese e Librit Universitar. Këtij botimi të ri, të miratuar nga Këshilli shkencor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, i janë shtuar edhe nëntë artikuj të tjerë, kryesisht kumtesa të mbajtura nga autori në sesionet më të fundit shkencore (në Tiranë, Prishtinë etj.), ku trajtohen çështje nga më të rëndësishmet që kanë të bëjnë me gjuhën standarde shqipe, të cilat kanë shqetësuar e vijnë të shqetësojnë mbarë shqiptarët, por më shumë studiuesit, mësuesit, studentët dhe nxënësit, duke iu përgjigjur kështu edhe kërkesave aktuale të gjuhësisë shqiptare për bazën dialektore të shqipes standarde, gjendjen e normës letrare dhe detyrat e sotme për përsosjen e mëtejshme të saj nga ana strukturore e funksionale.

Gjithë lënda (me gjithsej 44 tituj) është sistemuar e klasifikuar sipas tematikës në tre krerë, që kanë secili nga një titull të veçantë: I. *Çështje të historisë së shqipes standarde*, II. *Çështje të standardizimit* dhe III. *Gjuha standarde shqipe e shkolla*. Në krye të vëllimit jepet bashkë me *Parathënien* e botimit të parë, një *Parathënie e re* e botimit të dytë (të shkruara nga autori), të shoqëruara me një *Hyrje* vlerësuese të këtij vëllimi (të shkruar nga prof. E. Hysa). Ndërsa në fund libri ka një bibliografi të pasur (me 250 tituj), së cilës, në krahasim me të parën, i janë shtuar 50 tituj të rinj, që janë studime të gjuhëtarëve nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia dhe i kanë shërbyer autorit si mbështetje teorike për të gjithë artikujt e këtij vëllimi.

Vlerat kryesore të këtij botimi mund të përmbliidhen si më poshtë:

1. Këta artikuj, pavarësisht nga ndonjë përsëritje, shtrojnë pyetje e probleme nga më të mprehtat, që kanë dalë në procesin e zhvillimeve brenda shqipes dhe kanë ngjallur mjaft diskutime, madje edhe kundërshtime, të cilat kanë të bëjnë me formimin e gjuhës së përbashkët letrare kombëtare, me normën e njëzuar dhe me variantet e saj si dhe me shmangiet nga norma, me drejtshkrimin e

drejtshqiptimin, me kodifikimin e leksikut nëpër fjalorët shpjegues dhe rolin e tyre për pasurimin e shqipes etj.

2. Në këtë botim pasqyrohet përvoja 30-vjeçare e autorit si një studiues i kualifikuar, i zellshëm e këmbëngulës, ku shfaqet korrektësia dhe koherenca, aftësia kërkuese e hulumtuese dhe ndihmesa e tij vetjake në trajtimin dhe në rrugët e *zgjidhjen* që ai propozon për mjaft çështje të rëndësishme gjuhësore brenda kësaj fushe. Në këtë vëllim bie në sy metoda shkencore bashkëkohore e analizës së problemeve nga më të ndërlikuarat, vlerësimi me karakter objektiv e kritik i punës së kryer deri tani dhe i pikëpamjeve të lidhura me bazën e variantit letrar të toskërishtes, me karakterin mbidialektor të shqipes standarde përkundër karakterit “sui generis” të formimit të saj etj.

3. Të gjithë artikujt studimorë mbështeten në një koncept të drejtë shkencor të autorit për gjuhën standarde në përgjithësi dhe për shqipen standarde në veçanti të vendosur në Kongresin e Drejtshkrimit (1972), të cilën ai e quan “një arritje të rëndësishme” dhe “një pasuri të mbarë kombit shqiptar, pavarësisht nga kufijt shtetërorë e rendet politike” (fq. 17). Në këta artikuj mbrohet identiteti i shqipes standarde dhe vlerat e saj si gjuhë e përbashkët letrare, duke mos u pajtuar me asnjë lloj politizimi (nga të dy krahët) rreth standardizimit të saj. Aty vlerësohet në mënyrë pozitive puna e kryer nga institucionet e Akademisë së Shkencave në fushën e gjuhësisë, por theksohen edhe mundësitë reale për përsosjen e mëtejshme të standardit gjuhësor në kushtet e sotme të zhvillimeve demokratike të shoqërisë në vendin tonë.

4. Interes të veçantë shkencor paraqesin artikujt e fundit të autorit, që i janë shtuar botimit të parë, lidhur me paskajoren në shqipen e sotme, me ndihmesën e gjuhësisë kosovare në fushën e standardizimit të shqipes, me hartimin e fjalorëve të rinj, me nevojën e një politike të re gjuhësore mbarëkombëtare etj.

5. Këto studime kanë vlera aktuale dhe e zgjerojnë rrezën e shërbimit e të përdorimit të këtij botimi të ri jo vetëm nga ana e studiuesve gjuhëtarë, por edhe nga ana e mësuesve të gjuhës shqipe në shkolla, nga punonjësit e medias së shkruar dhe elektronike, nga redaksitë e shtëpive botuese, nga shkrimtarët e poetët shqiptarë, veçanërisht nga gjuhëtarët më të rinj të cilëve u bie detyra të çojnë më përpara

studimet në këtë fushë. Pedagogët e gjuhës në shkollat e larta mund ta përdorin këtë botim si tekst mësimor universitar e pasuniversitar ose si bibliografi a literaturë plotësuese për temat e diplomave të studentëve, në seminare për çështje gjuhësore etj.

Miço SAMARA

